



KRYETARI I KOMUNËS
Nr. 178 datë: 27.06.2022

Bazuar në nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 78 shkronja h) të Statutit Sh01.Nr.005/2008 të datës 26.09.2008 dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit Sh01.Nr.15/2010 të datës 31.02.2010, nenit 6 nënparagrafi 2.1 dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, Kryetari i Komunës së Kamenicës paraqet kërkesë për miratim:

PROPOZIM - NISMËN
PËR BASHKËPUNIM NDËR KOMUNAL PËR PROJEKTIN “ LUGU I VERDHË”
NË MES KOMUNËS SË KAMENICËS DHE KOMUNËS SË NOVOBËRDES

1. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet me Komunën e Kamenicës dhe Komunën e Novobërdes për realizimin e Projektit “LUGU I VERDHË” .
2. Qëllimi i bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Kamenicës dhe Komunës së Novobërdes do të bëhet në fushën e realizimit të Projekteve të përbashkëta ndërmjet këtyre dy Komunave.
4. Bashkangjitur me nismën gjeni letërzotimin për bashkëpunim komunal dhe marrëveshjen për bashkëfinancim të nënshkruar nga Komunës së Kamenicës dhe Komunës së Novobërdes.
5. Pas miratimit nga Kuvendit Komunal Kamenicë Propozim Nisma hyn në fuqi 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj

Letërzotim për Bashkëpunim Ndër Komunal për fazën e parë të aplikimit

Në pajtim me kriteret e thirrje të publikuara nga MAPL, me datë 16.12.2021, në kuadër të instrumentit për investime kapitale (CIF) për zhvillim të qëndrueshëm komunal, dhe me qëllim të aplikimit për financim të projektit të përbashkët në fushën e bashkëpunimit ndër-komunal nënshkruhet ky:


1. LETËR ZOTIM PËR BASHKËPUNIM NDËR KOMUNAL PËR PROJEKT-PROPOZIMIN: "LUGU I VERDHË" NË MES TË:

1.1. Komunës së Kamenicës si aplikues kryesor,


1.2. Komunës së Novobërdës si bashkë-aplikues,

2. Me rastin e nënshkrimit të këtij letër zotimi, Komuna e Kamenicës, zotohet se do ta bashkë-financoj projekt propozimin nëse i njëjti përzgjidhet për financim nga CIF.
3. Me rastin e nënshkrimit të këtij letër zotimi, Komuna e Novobërdës zotohet se do ta bashkë-financoj projekt propozimin nëse i njëjti përzgjidhet për financim nga CIF.
4. Komunitat nënshkruese obligohen që nëse projekt propozimi kalon fazën e parë të vlerësimit, atëherë të njëjtat do të ndjekin të gjitha procedurat për lidhje të marrëveshjes së bashkëpunimit ndër-komunal sipas LIGJI Nr. 04/L-010 PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL.

Kryetari i Komunës së Kamenicës



Kadri Rahimaj



Kryetari i Komunës së Novobërdës



Sasa Milosevic



Në pajtim me kriteret e thirrjes të publikuar nga MAPL, me datë 16.12.2021, në kuadër të instrumentit për investime kapitale (CIF) për zhvillim të qëndrueshëm komunal, dhe me qëllim të aplikimit për financim të projektit të përbashkët në fushën e bashkëpunimit ndër-komunal nënshkruhet kjo:

MARREVESHJE PËR BASHKËFINANCIM

PËR PROJEKTIN: LUGU I VERDHË

NË MES TË

1.1. Komunës së Kamenicës si aplikues kryesor,


1.2. Komunës së Novobërdës si bashkë-aplikues,


2. Me rastin e nënshkrimit të kësaj marreveshje, te dy komunat do të kontribuojnë në vlerë prej 100,000.00 euro

3. Komuna e Kamenicës do të bashkë-financoj në vlerë prej 98,000.00 euro projektin nëse i njëjti përzgjidhet për financim nga CIF.

4. Komuna e Novobërdës, do të bashkë-financoj në vlerë prej 2,000.00 euro projektin nëse i njëjti përzgjidhet për financim nga CIF.

5. Komunat nënshkruese obligohen që nëse projektin kalon fazën e parë të vlerësimit, atëherë të njëjtat do të ndjekin të gjitha procedurat për lidhje të marrëveshjes së bashkëpunimit ndër-komunal sipas LIGJI Nr. 04/L-010 PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL.

Kryetari i Komunës së Kamenicës

Kadri Rahimaj



Kryetari i Komunës së Novobërdës

Sasa Milosevic

